



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Letërsi e Gjuhës B (1)

Ngarkesa: 4 kredite, 45 orë mësimore; 30 leksion/15 seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Studenti duhet të jetë i aftë: Të përfitojë njohuri të përgjithshme lidhur me zhvillimet letrare, sociale, politike, ekonomike dhe kulturore, që karakterizojnë shoqërinë italiane të shek. XIII-XVI. Të njohë letërsinë italiane të shek. XIII-XVI dhe rolin e shkrimtareve kryesore të periudhës; Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi momentet kyçe të letërsisë & kulturës italiane të shek. XIII-XVI. Të prezantojë dhe të komentojë letërsinë & kulturën italiane të shek. XIII-XVI.

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Të përvetësoj njohuritë e plota si edhe krijimi i një këndvështrimi historiko-kritik të letërsisë italiane nga Fillesat deri në shekullin e XVI.
2. Strukturimi paraqet një lexim diakronik të traditës lirike italiane nga shek. XIII në shek. XVI, temën e peizazhit në letërsi në shek. XVIII dhe një lexim monografik të “*Canzoniere*” të Petrarckës.
3. Të përvetësoj njohuri metodologjike dhe kritike të letërsisë italiane. Për këtë arsye u kushtohet një vëmendje e vecantë përdorimit të teknikave dhe mjeteve didaktike në qasjen ndaj tekstit.
4. Synohet formimi i një studenti kompetent ndaj nevojave gjuhësore që parashtron sot në mënyrë të pashmangshme bota e komunikimit dhe e mediave;

Rezultate të pritshme:

1. Aftësia për analiza letrare të periudhës përkatëse.
2. Aftësia për të ushtruar mendime analitike, kritike dhe logjike në interpretimin e dukurive të ndryshme letrare.
3. Aftësia për të njohur proceset letrare-kulturore italiane të shek. XIII-XVI.
4. Aftësia për t’i përshkruar veprat letrare të autoreve italiane të shek. XIII-XVI në mënyrë analitike duke përdorur terminologjinë specifike të fushës letrare.